ii/c. Organizimi dhe Stafit: Operatori ekonomik duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e stafit të tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomik-administrativ.

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

a- Kualifikim i përgjithshëm

b. Eksperienca në fushën përkatëse

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.
- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

2. Vlerësimi i Propozimeve Ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Propozimi Ekonomik do të ketë 20 pikë

Pe- Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (*duke filluar nga çmimi më i ulët*)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Vlerësimi përfundimtar

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.8)$

pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

$$\text{Oferta më e mirë} = X + Y$$

Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHËNIM: 1. Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kritere vlerësimi një

nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

22. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim

ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kudër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kudër/Kontratën.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: [Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE], përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne [vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti], nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës [vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit].
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për [vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE] në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]
[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Objekti i kontratës: **Shërbim i Pastrimit të Zonës Bregdetare për Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë, Sarandë dhe Pogradec**

Akronime:

Autoritet kontraktor-Autoriteti/insitucioni kërkues dhe financues i këtij shërbimi, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Republika e Shqipërisë

- **Operator i shërbimit:** Kompania/shoqëria/konsorcium që do të kontraktohet për zbatimin e kontratave
- **Plazh publik:** vend i përcaktuar nga bashkia si i tillë.
- **Zonë pastrimi:** Zonë e përcaktuar nga autoritet kontraktor si objekt i shërbimit të pastrimit.
- **PGM-Pikë grumbullimi e mbetjeve**

Zëri 1: Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve Urbane.

Metodologjia dhe Specifikimet teknike

Ky shërbim konsiston në largimin e mbetjeve të depozituara në konteineret e depozitimit të mbetjeve nga subjektet/banorët/operoret e pastrimit apo gjithkush tjetër që operon brenda zonës së pastrimit.

Volumet e punimeve dhe frekuenca e shërbimit

Autoriteti kontraktues për llogaritjen e kostos së grumbullimit dhe transportit të mbetjeve ka zbatuar modelin e llogaritjes së kësaj kostoje konform shtojcës 1 të zbatuar VKM Nr. 319, datë 31.5.2018 “Për Miratimin e Masave Për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.

Autoriteti kontraktor ka përcaktuar në kontratat me qeverisjet vendore të Shkodrës, Lezhës, Durrësit, Kavajës, Pogradecit, Rrogozhinës, Divjakës, Fierit, Vlorës, Himarës dhe Sarandës, numrin e konteinerëve, zonat ku do të vendosen si edhe frekuencën e terheqjes së tyre (2 herë në ditë, përgjatë fashës orare 18-00-06.00, gjatë 93 ditëve të sezonit turistik pra përgjatë periudhës 15 Qershor–15 Shtator 2026.). Këto të dhëna jepen sipas tabelës nr. 1

Tabela 1

SIPËRFAQE

LOTI	BASHKIA ZONA	/KONTEJNERË 1100/1700 L	KONTEJNERË 240 L	SIPËRFAQE PLAZHI (M ²)	SHËTITORE / RRUGË (M ²)
LOTI 1	SHKODËR (VELIPOJË)	400	—	71,464	30,000

LOTI 1	LEZHË	400	220	18,000	—
LOTI 1	DURRËS	570	40	547,394	18,116
LOTI 1	KAVAJË (GOLEM)	220	30	148,763	16,200
LOTI 1	POGRADEC	135	—	12,000	—
LOTI 2	RROGOZHINË	100	100	151,212	—
LOTI 2	DIVJAKË	55	35	55,266	—
LOTI 2	FIER	62	—	193,970	—
LOTI 2	VLORË	196	54	977,138	30,000
LOTI 2	HIMARË	322	319	149,617	16,900
LOTI 2	SARANDË	256	120	83,551	13,543

Bashkia	Nr	Zona Plazhit	Kontenie r Lloji 1	Kontenie r Sasia 1	Kontenie r Lloji 2	Kontenie r Sasia 2	Kontenie r Lloji 3	Kontenie r Sasia 3	Orari i Pastrimit
Himarë	1	Plazhi Palasë	1100 L	20	240 L	15			18:00-06:00
Himarë	2	Plazhi Dhërmi-Drimadhë	1100 L	100	240 L	80			18:00-06:00
Himarë	3	Plazhi Jalë	1100 L	20	240 L	20			18:00-06:00
Himarë	4	Plazhi Livadh	1100 L	20	240 L	40			18:00-06:00
Himarë	5	Plazhi Himarë	1100 L	100	240 L	80			18:00-06:00
Himarë	6	Plazhi Llaman	1100 L	10	240 L	20			18:00-06:00
Himarë	7	Plazhi Qeparo	1100 L	20	240 L	40			18:00-06:00
Himarë	8	Plazhi Borsh	1100 L	20	240 L	14			18:00-06:00
Himarë	9	Plazhi Bunec	1100 L	4	240 L	6			18:00-06:00
Himarë	10	Plazhi Lukovë	1100 L	8	240 L	4			18:00-06:00
total HIMARË				322		319			
Pogradec	1	Lin	1100 L	10	240 L	-			18:00-06:00
Pogradec	2	Piskupat	1100 L	5	240 L	-			18:00-06:00
Pogradec	3	Udenisht	1100 L	10	240 L	-			18:00-06:00
Pogradec	4	Memelisht	1100 L	10	240 L	-			18:00-06:00

Pogradec	5	Pogradec-Tushemishit	1100 L	100	240 L	-			18:00-06:00
Pogradec	6	Pogradec	12 L	150	10 L	30			18:00-06:00
TOTAL Pogradec				135		30			
Divjakë	1	Plazhi Divjakë	1100 L	55	240 L	35			18:00-06:00
Kavajë	1	Plazhi Golem-Qerret	1700	220	240 L	168			18:00-06:00
Kavajë	2	Plazhi Karpen	1100 L	30	240 L	18			18:00-06:00
Total Kavaje				250		186			
Shkodër	1	Plazhi Velipojë	1100 L	300	240 L	-			18:00-06:00
Shkodër	2	Plazhi Baks-Rrjoll	1100 L	100	240 L	-			18:00-06:00
total Shkoder				400					
Rrogozhinë	1	Plazhi Spille	1100 L	100	240 L	100			18:00-06:00
Durrës	1	Plazhi Gjiri Lalzit	1100 L	100	240 L	-			18:00-06:00
Durrës	2	Plazhi Currila-Kallm	1100 L	25	240 L	-			18:00-06:00
Durrës	3	Plazhi Currila	1100 L	75	240 L	40			18:00-06:00
Durrës	4	Plazhi madhë	1100 L	370	240 L	450	30 L	-	18:00-06:00
total Durres				570		40			
Lezhë	1	Rrjollë	1100 L	-	240 L	150			18:00-06:00
Lezhë	2	Rana Hedhun	1100 L	-	240 L	70			18:00-06:00
Lezhë	3	Shëngjin	1100 L	300	30 L	0			18:00-06:00
Lezhë	4	Tale	1100 L	100	30 L	70			18:00-06:00
Total Lezhe				400					
Sarandë	1	Sarandë Pllakat	1100 L	44	240 L	-			18:00-06:00

Sarandë	2	Sarandë Qytet	1100 L	57	240 L	70	20 L	30	18:00-06:00
Sarandë	3	Ksamil	1100 L	33	240 L	-			18:00-06:00
Sarandë	4	Ksamil 1	1100 L	122	240 L	50			18:00-06:00
Sarande TOTAL				256		120			
Vlorë	1	Plazhi Akerni	1100 L	13	240 L	-			18:00-06:00
Vlorë	2	Plazhi Zvërnec	1100 L	10	240 L	-			18:00-06:00
Vlorë	3	Plazhi Zvërnec 1	1100 L	15	240 L	-			18:00-06:00
Vlorë	4	Plazhi Vjetër	1100 L	6	240 L	27			18:00-06:00
Vlorë	5	Plazhi Lungomare-Uji Ftohtë	1100 L	97	240 L	9			18:00-06:00
Vlorë	6	Plazhi Radhimë-Orikum	1100 L	55	240 L	18			18:00-06:00
Vlore Total				196		54			
Fier	1	Plazhi Seman 1	1100 L	21	240 L	-			18:00-06:00
Fier	2	Plazhi Seman 2	1100 L	4	240 L	-			18:00-06:00
Fier	3	Plazhi Darëzezë-Pishë Poro	1100 L	37	240 L	-			18:00-06:00
Total Fier	43			62					

Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve urbane konsiston në:

1. Zbrazen e kontenierëve dhe ngarkimin e mbetjeve të depozituara në këto konteinerë në makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar.
2. Mbledhjen dhe largimin e mbetjeve të hedhura përreth në një sipërfaqe 30 m² përreth çdo PGM-je.
3. Rivendosjen e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Konteinerët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban.
4. Dezinfektimin në përfundim, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori, brenda çdo kontenieri.
5. Transportimin e mbetjeve deri në vendin e përcaktuar nga bashkia përkatëse.

Sipas të dhënave të marra nga Agjensia e Bregdetit, pikat fundore të depozitimit të mbetjeve do të jenë si më poshte:

Tabela 2

BASHKIA / ZONA	LLOJI I SHËRBIMIT	PIKA FUNDORE E DEPOZITIMIT	DISTANCA GRUMBULLIM (KM)	DISTANCA TRANSPORT (KM)
SHKODËR (VELIPOJË)	1100/1700 L	LANDFILL BUSHAT	11.0	32.0
LEZHË	1100/1700 L	LANDFILL BUSHAT	24.0	26.0
LEZHË	240 L	LANDFILL BUSHAT	26.0	24.0
DURRËS	1100/1700 L	LANDFILL I SHARRËS (TIRANË)	28.0	40.0
DURRËS	240 L	LANDFILL I SHARRËS (TIRANË)	9.0	40.0
KAVAJË (GOLEM)	1100/1700 L	LANDFILL I SHARRËS (TIRANË)	11.0	28.0
KAVAJË (GOLEM)	240 L	LANDFILL I SHARRËS (TIRANË)	32.0	10.0
POGRADEC	1100/1700 L	LANDFILL RAJONAL MALIQ	33.0	27.0
RRIGOZHINË	1100/1700 L	INCENERATOR ELBASAN	5.0	79.0
RRIGOZHINË	240 L	INCENERATOR ELBASAN	5.0	79.0
DIVJAKË	1100/1700 L	NDËRMARRJA PASTRIMIT FIER	11.0	34.0
DIVJAKË	240 L	NDËRMARRJA PASTRIMIT FIER	11.0	34.0
FIER	1100/1700 L	INCENERATOR FIER	11.0	57.0
VLORË	1100/1700 L	FUSHA E VJETËR E AVIACIONIT	48.0	7.0
VLORË	240 L	FUSHA E VJETËR E AVIACIONIT	11.0	39.0
HIMARË	1100/1700 L	LANDFILL BAJKAJ	48.0	41.0
HIMARË	240 L	LANDFILL BAJKAJ	32.0	69.0

SARANDË	1100/1700 L	LANDFILL BAJKAJ	15.0	29.0
SARANDË	240 L	LANDFILL BAJKAJ	36.0	22.0
Bashkia/zona		Vend i depozitimit të mbetjeve	Distanca për Grumbullimin e mbetjeve (km)	Dsiatnca për transportin e mbetjeve (km)
Himare për konteineret 240 litra		Landfill Bajkaj	32	69
Velipoje për konteineret 1100 litra		Landfill Bushat	11	32
Vlore konteinere 1100 litra		Fusha e vjeter e Aviacionit	48	7
Vlore konteinere 240 litra		Fusha e vjeter e Aviacionit	48	2
Durres për konteineret 1100 litra		Landfill i Sharres (Tirane)	28	40
Golem për konteineret 1700 litra		Landfill i Sharres (Tirane)	11	39
Golem për konteineret 240 litra		Landfill i Sharres (Tirane)	10	32
Himare për konteineret 1100 litra		Landfill Bajkaj	48	42
Rrogozhine konteinere 1100 litra		Elbasan Incenerator	5	79
Rrogozhine konteinere 240 litra		Elbasan Incenerator	5	79
Sarande për konteineret 1100 litra		Landfill Bajkaj	15	29
Sarande për konteineret 240 litra		Landfill Bajkaj	36	22
Divjake për konteineret 1100 litra		Nderrmarrja pastrimit Fier	11	34
Divjake për konteineret 240 litra		Nderrmarrja pastrimit Fier	11	34
Lezhe konteinere 1100 litra		Incenerator Fier	11	57
Fier për konteineret 240 litra		Landfill i Sharres (Tirane)	9	40
Lezhe konteinere 1100 litra		Landfill Bushat	26	24
Pogradec konteinere 1100 litra		Landfill rajonal Maliq	33	27

Plani i vendosjes së kontenierëve dhe organizimi i shërbimit.

Autoriteti kontratues numrin e kontenierëve për secilën zonë të bashkive në marrëveshjen me këtë të fundit.

- Operatori i shërbimit është i detyruar të bëjë grumbullimin dhe transportin e mbetjeve nga pikat e grumbullimit të tyre deri në pikën fundore të depozitimit të tyre (të përcaktuar në tabelën nr 2. **Ky shërbim do të kryhet jo më pak se 2 herë për çdo zonë, brenda fashës orare 18.00-06.00.**
- Organizimi i procesit të punës duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të gjitha punimet të kryhen brenda orëve të natës, duke filluar jo më parë se ora 18.00, me qëllim që në orën 06.00 zona e kontraktuar të jetë krejtësisht e pastër.
- Autoritetit kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbetjeve për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin

e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjoba për mospërbushjen e tyre.

Rregulla për tu zbatuar

- Rrugëtimi i mjeteve i realizuar nëpërmjet software ArcMap 10.8, ka përcaktuar rrugëtimin e optimizuar të mjeteve që nënkupton rrugën me kosto distance më të mirë. Mjetet duhet të leviznin sipas këtij rrugëtimi, përveç rateve kur kushtet e rrugës përgjatë periudhës së zbatimit të kontratës (riparime, mbyllje të perkohshme, ndryshime kahu levizje) nuk do ta lejojnë një gjë të tilla. Gjithsesi Autoriteti Kontraktor nuk do të kompensojë rritjen e koston të transportit për shkak që nuk varen nga ky autoritet.
- Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të patransportuara dhe mbeturina të lëna në zonen përreth kontenerëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 2 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik.
- Operatori i shërbimit ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që depozitohen në ambjente publike brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të përsëritur operatori i shërbimit ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së kontenerëve dhe përfshirjen në grafikun e punimeve.
- Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.
- Nëqoftë se gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve të rëna gjatë transportit, ai do të përballë me penalitetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjoba të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.
- Përdorimi i uniformave për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mozbatimi aplikohen gjoba për mosplotësim këtij detyrimi. Cdo punëtor duhet të jetë i pajisur me univorma dalluese pune fosfoeshente duke qene që janë të ekspozuar ndaj levizjes së automjeteve apo aksidenteve të mundshme rrugore

Mjetet dhe pajisjet

Makinat e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve urbane të kërkuara për këtë shërbim, të cilat kanë dalë nga llogaritjet sipas VKM 319 VKM Nr.319, datë 31.5.2018 “Për Miratimin e Masave Për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, jepen sipas tabelës nr 3. Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, (mbledhjes, transportit, largimit të mbetjeve) dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

1. Makina teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve (Kompator), me ngarkim fundor ose anësor.

- Te dhenat mbi kapacitein mbajtës dhe transportues të mbetjeve që do të grumbullohen dhe transportohen nga zonat e pastrimit jepen sipas tabelës nr. 3
- Makinat duhet të jenë të pajisuara me mekanizëm fundor që lejon kapjen dhe zbrazjen brenda tyre të konteinerëve sipas llojit dhe përmasave të tyre. **Pra në** zonat ku konteineret janë 1100 litra mekanizmi duhet të jetë i pershatshëm për këtë lloj konteineri; në zonat ku konteineret

jane 240 litra mekanizmi duhet te jete i pershatshëm per këtë lloj konteineri, dhe aty ku konteineret jane 1700 litra mekanizmi duhet te jete i pershatshëm per kete lloj konteineri.

2. Konteinerët për depozimin e mbetjeve të specifikuar në tabelen nr.1.

Tabela 3

LOTI	MJETI MINIMAL	SASIA
LOTI 1	KOMPATATOR, MIN. 10 TON	5
LOTI 1	KOMPATATOR, 7-8 TON	8
LOTI 1	KOMPATATOR, 5-6 TON	2
LOTI 1	KOMPATATOR, DERI NË 1 TON	3
LOTI 1	AUTOBOT UJI, MIN. 8,000 L, POMPË PRESIONI	3
LOTI 1	SKARRABEL	2
LOTI 1	AUTOBOT VAKUM/LAVAZH, 2,000-3,000 L	2
LOTI 1	AUTOBOT VAKUM/LAVAZH, MAX. 1,000 L	1
LOTI 2	KOMPATATOR, MIN. 10 TON	3
LOTI 2	KOMPATATOR, 8-10 TON	3
LOTI 2	KOMPATATOR, 6-7 TON	2
LOTI 2	KOMPATATOR, 3-5 TON	2
LOTI 2	CISTERNA UJI, MIN. 25,000 L	2
LOTI 2	AUTOBOT UJI, MIN. 8,000 L, SPRUCIM	2
LOTI 2	SKARRABEL	2
LOTI 2	AUTOBOT VAKUM/LAVAZH, 2,000-3,000 L	2
LOTI 2	AUTOBOT VAKUM/LAVAZH, MAX. 1,000 L	1
TË DY LOTET	TUALETE PORTATIVE, STANDARDI UNI EN 16194 OSE EKUIVALENT ≥ 20	

**Numri i makinave reflekton edhe kërkesën e Autoritetit kontraktor të frekuencës së këtij shërbimi e përcaktuar si 2 here në ditë.*

Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:

- Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontratues për gjëndjen e gatishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
- Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuara nga Autoriteti kontratues. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të jenë gjendje për të siguruar plotësimin e gatishmërisë së mjeteve.

- Automjetet e largimit të mbetjeve duhet të lahen dhe dezinfektohen çdo ditë pas përfundimit të punës.
- Të gjithë kontenierët e përdorur për zbatimin e kontratës duhet të mbahen të pastër, në gjëndje të mirë teknike. Në rast dëmtimesh, djegiesh, deformimesh të kontenierëve, si dhe dëmtime rrotash dhe kapakësh, të cilat çojnë në mosfunksionimin e plote teknik, higjienik ose estetik të tij gjatë kohëzgjatjes së kontratës si dhe mungesës së kontenierëve, operatori i shërbimit ka përgjegjësinë për ruajtjen, mirëmbajtjen e kontenierëve për çdo rast dhe për çdo shkak.

Zëri 2- Mirëmbajtja e shetitoreve të plazheve dhe zbrazja e koshave 30, 20, 10 litra

Ky shërbim konsiston në largimin e mbetjeve, pastrimin e koshave rrugorë në shëtitoret pranë plazheve.

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht të gjitha zonat dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar. Keto zona janë shetitoret e plazheve, brenda zones të përcaktuara në VKM nr 569, datë 17.07.2019, e ndryshuar. Operatori i shërbimit do të mirëmbajë të gjitha shëtitoret e plazheve, në zonën që do të kontraktohet, sipas tabelës 5.

Volumi i punimeve

Tabela 5

BASHKIA ZONA	SIPËRFAQE REFERENCE SHËTITORE/RRUGË (M²)	PUNONJËS REFERENCE	FREKUENCA	FASHA ORARE
SHKODËR (VELIPOJË)	30,000	5	1 HERË/DITË	18:00–24:00
DURRËS	18,116	3	1 HERË/DITË	18:00–24:00
KAVAJË (GOLEM)	16,200	3	1 HERË/DITË	18:00–24:00
Lezhë (Shëngjin)	18,000	3	1 HERË/DITË	18:00–24:00
Pogradec	12,000	3	1 HERË/DITË	18:00–24:00
VLORË	30,000	5	1 HERË/DITË	18:00–24:00
HIMARË	16,900	3	1 HERË/DITË	18:00–24:00
SARANDË	13,543	2	1 HERË/DITË	18:00–24:00
Totali	154,759	26		

Rrogzhina, Divjaka dhe Fieri nuk përfshihen në këtë zë, për sa kohë që në specifikimet aktuale nuk kanë volum të përcaktuar të shetitoreve/rrugëve për këtë shërbim. Durrësi, Lezha dhe Pogradeci mbeten të përfshirë sipas volumeve operative të identifikuara në preventivat përkatëse.

Mirëmbajtje shetitoresh dhe pastrim i koshave rrugore

Zona	Volum total(m ²)	Volum ditor(m ²)	Kosha rrugore ne dite(cope)	Dite pune
Velipoje	30,000	30,000	0	93
Durres	18,116	18,116	230	93
Golem	16,200	16,200	0	93
Rrogozhine	0	0	0	0
Divjake	0	0	0	0
Fier	0	0	0	0
Vlore	30,000	30,000	0	93
Himare	16,900	16,900	0	93
Sarande	13,543	13,543	0	93
Pogradec	12,000	12,000	30	93
Lezhe(shengjin)	18,000	18,000	220	93

Ky shërbim do të kryhet cdo dite përgjate 93 diteve dhe frekuenca e tij do jete 1 here në ditë ne orarin 18-00-24.00

Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i mirëmbajtjes dhe pastrimit të trotuareve dhe kunetave të akseve kryesore, konsiston në:

- Mirëmbajtjen dhe pastrimin me punëtorë të shetitoret e plazheve, trotuaret e rrugëve kryesore dhe sheshet brenda zones te percaktuar ne VKM nr 569, duke mbledhur dhe larguar të gjitha mbetjet e vogla dhe të mëdha të hedhura në sipërfaqet për mbulim si rezultat i aktivitetit tregtar dhe të këmbësorëve
- Pastrimin dhe mbajtjen pastër gjatë ditës të koshave rrugorë dhe vendit rreth tyre.
- Zbrazjen e koshave rrugore 30 litra (ne zonën bregdetare të bashkive ku ato ndodhen Durrës, Sarandë, Lezhe) dhe dergimin e mbetjeve te depozituara atje drejt konteinereve te medhenj qe ndodhen ne zone te cilat jane objekt pune i zerit "Grumbullim dhe transport mbetjesh).

Normativat e ketij sherbimi: Per kete shërbim nuk ka nje normë fikse të paracaktuar ne kornizen mjedisore apo didaktike te menaxhimit te mbetjeve dhe duke iu referuar normës së shërbimit të fshirjes së rrugeve (edhe kjo e fundit jo fikse ku disa bashki perdorin normen 4000 m²/punëtor Bashkia Tiranë, 9000 m²/punëtor Bashkia Sarandë, 6000 m²/punëtor Bashkia Kurbin etj). Duke parë këtë situatë rekomandohet nje norme e mesatarizuar ditore prej 6000 m²/punëtor.

Metodologjia e kryerjes së shërbimit: Punëtorët do te grumbullojnë mbetjet e hedhura apo te depozituara ne koshat rrugore dhe do të depozitojnë ato në pikën më të afërt të grumbullimit të mbetjeve, për të shmangur ndikimet e cilësuar në pikën 1, dhe që në cdo kohe brenda fashës orare te pastrimit dhe me vonë, shetitoret të rezultojnë të pastruara. Punëtorët duhet te përdorin dorëza profesionale dhe kapëse për mbetjet, në mënyrë që të shmangin ndonjë incident të mundshëm dhe të sillen konform rregullave të shëndetit dhe sigurisë në punë.

Plani i punës dhe grafikët e punimeve

- a. Mirëmbajtja e shetitoreve dhe zbrazja e koshave rrugorë do të bëhet gjatë fashës orare **18.00 -24.00.**
- b. Kontraktori do të duhet të parashikojë një ndarje proporcionale të territorit (shetitoreve) ku punetoret të kryejnë këtë shërbim në funksion të mbulimit sa më të mirë të territorit.

Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

Rregulla për tu zbatuar

- Operatori i shërbimit duhet të mbajë të pastër të gjithë sipërfaqen e planifikuar në përputhje me kushtet e kësaj kontrate.
- Për asnjë rast nuk do të lejohen shetitoret të papastruara apo kosha rrugorë të pa zbratur nga mbetjet. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik
- Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të këtij shërbimi.
- Gjatë procesit të mirëmbajtjes së shetitoreve dhe pastrimit të koshave rrugorë, punonjeseve ndalohej kategorikisht hedhja e mbetjeve në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit, ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse zonat e gjelbra, në burimet ujore natyrore apo artificiale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie operatori i shërbimit detyrohet t'i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes apo mospastrimit të tyre brenda 3 orësh nga marrja e njoftimit, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballet me penalitete sipas kësaj kontrate dhe ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

Mjetet dhe pajisjet

- Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastikedorezë e gjatë kapëse për mbetjet, (jane të specifikuar në analizen e kostos për këtë zë punimesh), për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.
- Cdo punëtor duhet të jetë i pajisur me univorma dalluese pune fosforeshente duke qenë që jane të ekspozuar ndaj levizjes së automjeteve apo aksidenteve të mundshme rrugore.

Zeri 3- Pastrimi i plazheve publike nga mbetjet

Volumi i punimeve

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht të gjitha zonat dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar. Këto zona janë shetitoret e plazheve, brenda zonës të përcaktuar në VKM nr 569, datë 17.07.2019, e ndryshuar. Operatori i shërbimit do të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha trotuaret e akseve kryesore të përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, për sipërfaqet e plazheve sipas tabelës 6.

Tabela 6

BASHKIA / ZONA	SIPËRFAQE REFERENCE PLAZHI (M ²)	PUNONJËS REFERENCE	FREKUENCA	FASHA ORARE
SHKODËR (VELIPOJË)	71,464	6	1 HERË/DITË	18:00–22:00
LEZHË	18,000	2	1 HERË/DITË	18:00–22:00
DURRËS	547,394	50	1 HERË/DITË	18:00–22:00
KAVAJË (GOLEM)	148,763	14	1 HERË/DITË	18:00–22:00
POGRADEC	12,000	2	1 HERË/DITË	18:00–22:00
RROGOZHINË	151,212	14	1 HERË/DITË	18:00–22:00
DIVJAKË	55,266	5	1 HERË/DITË	18:00–22:00
FIER	193,970	18	1 HERË/DITË	18:00–22:00
VLORË	977,138	89	1 HERË/DITË	18:00–22:00
HIMARË	149,617	14	1 HERË/DITË	18:00–22:00
SARANDË	83,551	8	1 HERË/DITË	18:00–22:00
TOTAL	2,408,375	222		

Pastrim I plazheve publike			
Zona	SIPERFAQE PLAZHEVE	SASIA DITORE	DITE TOTAL
Velipoje	71,464	71,464	93
Durres	547,394	547,394	93
Golem	148,763	148,763	93
Rrogozhine	151,212	151,212	93
Divjake	55,266	55,266	93
Fier	193,970	193,970	93
Vlore	977,138	977,138	93
Himare	149,617	149,617	93
Sarande	83,551	83,551	93
Pogradec	12,000	12,000	93
Lezhe	18,000	18,000	93
Total		2,408,375	

Lezha dhe Pogradeci përfshihen në Lotin 1 edhe në këtë zë, duke u bazuar në sipërfaqet e plazhit të parashikuara në Tabelën 1 të specifikimeve teknike dhe në analogjinë metodologjike të vitit 2025.

Specifikime teknike dhe metodologjia

1. Ky shërbim konsiston në largimin e mbetjeve që mund të lënë pushuesit në plazhet publike, te percaktuara nga pushteti vendor si të tillë. Në plazhet publike, pushuesit mund të konsumojnë pije apo ushqime dhe mund të ndodhë që ti lënë mbetjet në këto hapësira. Lënia e mbetjeve në këto hapësira publike ndikon negativisht në mjedis për aryet si më poshte:
 - Prish cilësinë e rerës/guravë të brigjeve ujore.
 - Ofron brejtësit dhe insektet si miza, grereza, mushkonja etj duke sjelle shqetësim te pushuesit duke rrezikuar jeten dhe shëndetin e tyre.
 - Rrit mundësinë e përhapjes së sëmundjeve për shkak edhe të temperaturave të larta gjatë sezonit të verës.
 - Mbetjet rrezikojnë që nga faktorë klimatikë apo meteologji (era, baticat) të përfundojnë në det duke ndotur mjedisin ujqor.
 - Krijojnë një peisazh jo-terheqës ndaj pushuesëve
 - Demtohet imazhi i zonës dhe i Shqipërisë që mund të sjelle ulje te numrit të turistëve për vitet e tjera.
 - Ndikon negativisht në ndërgjegjësimin e fëmijeve mbi mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e natyrës.
 - Rritje e kostos se pastrimit të zonës

Metodologjia e kryerjes së shërbimit: Punëtorët do të grumbullojnë mbetjet e lena nga pushuesit dhe do të depozitojnë ato në pikën më të afërt të grumbullimit të mbetjeve, për të shmangur ndikimet e cilësuar në pikën 1, dhe që ditën tjetër plazhi/hapësira të rezultojë e pastruar. Punëtorët duhet te përdorin dorëza profesionale për këtë qëllim në mënyrë që të shmangin ndonjë incident të mundshëm dhe të sillen konform rregullave të shëndetit dhe sigurisë në punë.

Ky shërbim do të kryhet cdo dite përgjate 93 diteve dhe frekuenca e tij do jete 1 here në ditë ne orarin **18-00-22.00**

